




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN



VENDIM

Nr.7, datë 04.07.2022

PËR

**MIRATIMIN E LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR  
SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK  
SHOQËRISË “BAJRAMI N” SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujqore, Këshilli i Basenit Ujqor Shkumbin.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik shoqërisë “Bajrami N”, me adresë Njësia Administrative Labinot Fushë Elbasan Qarku Elbasan sipas Miratimit Paraparak me Nr.7771/2 , datë 05.07.2018 për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë hidrocentralit “Bukaniku” që do të ndërtohet mbi Përroin e Qershive, degë e Lumit Gostime, Njësia Administrative Shushicë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan si dhe shtyrjes së afatit të Miratimit Paraparak për Hec “Bukaniku” me nr.2666/1 prot., date 30.03.2022 nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për shoqërinë “Bajrami N” .

2. Treguesit paraparak janë si më poshtë:

**HEC Bukaniku**

- Prodhimi vjetor i parashikuar: 3.660.000 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 1.100 kwh
- Vlera totale e investimit: 185.317.213,0 lekë

Vendndodhja e burimit ujqor Përroi i Qershive (degë e lumit Gostimë)

- X= 519737; Y= 4547254; Z=708.5 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Prurja llogaritëse: 0.55 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare vjetore: 0.388 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.136 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.054 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 1 (Përroi i Qershive dega kryesore)

- X= 519737; Y= 4547254; Z=708.5 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore: 0.308 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.108 m<sup>3</sup>/s
- Prurja llogaritëse: 0.43 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.043 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e veprës së marrjes 2 (Degëzim i Përroit të Qershive)

- X= 519012; Y= 4547597; Z=711 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja mesatare vjetore: 0.08 m<sup>3</sup>/s
- Prurja mesatare e muajit më të thatë: 0.028 m<sup>3</sup>/s
- Prurja llogaritëse: 0.12 m<sup>3</sup>/s
- Prurja ekologjike: 0.011 m<sup>3</sup>/s

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 518606; Y= 4549663; Z=453 m.m.n.d. (KRGJSH)

- Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
- Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

